

20261963170

МИНИСТЕРСТВО ЗА ЕКОНОМИЈА И ТРУД

Në bazë të nenit 17-e paragrafi (3) të Ligjit për siguri dhe shëndet gjatë punës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 92/07, 136/11, 23/13, 25/13, 137/13, 164/13, 158/14, 15/15, 129/15, 192/15 dhe 30/16, si dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 18/20 dhe 74/25), Ministri i Ekonomisë dhe Punës solli:

R R E G U L L O R E

PËR FORMULARIN E KËRKESËS DHE DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHËM PËR DHËNIEN E PROVIMIT PROFESIONAL PËR PERSONIN PROFESIONAL PËR SIGURI GJATË PUNËS

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet formulari i kërkesës dhe dokumentacioni i nevojshëm për dhënie e provimit profesional për personin profesional për siguri gjatë punës.

Neni 2

Kërkesa nga neni 1 i kësaj rregulloreje shtypet në formular në letër me ngjyrë të bardhë, në format A4, i cili është dhënë në Shtojcë dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 3

Me kërkesën nga neni 1 i kësaj rregulloreje, kandidati dorëzon dokumentacion për përmbushjen e kushteve për dhënie e provimit profesional, si vijon:

- vërtetim se ka vendbanim në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- diplomë për përfundimin e arsimit të lartë nga fusha e mbrojtjes gjatë punës, drejtimi teknik ose ndonjë drejtim tjetër që përputhet me veprimtarinë e punëdhënësit (diplomë për përfundimin e arsimit të lartë katërvjeçar ose diplomë me 300 kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS); dhe
- vërtetim se ka të paktën pesë vite përvojë pune pas diplomimit, në fushën përkatëse për të cilën është paraqitur kërkesa për dhënie e provimit profesional.

Neni 4

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr.12-5044/1
19.8.2026
Shkup

Ministri
Ekonomisë dhe Punës,
Besar Durmishi, d.v.



Republika e Maqedonisë së Veriut

Drejtuar Ministrisë së
Ekonomisë dhe Punës

KËRKESË

PËR DHËNIEN E PROVIMIT PROFESIONAL PËR PERSONIN PROFESIONAL PËR SIGURI GJATË PUNËS

Emri dhe mbiemri i kandidatit:	
Dita, muaji dhe viti i lindjes:	
Adresa e vendbanimit ose vendqëndrimit:	
Numër telefoni për kontakt:	

Me kërkesën bashkëngjis dokumentacionin e mëposhtëm (shënoni me rreth dokumentet që i bashkëngjisni):

- vërtetim për vendbanim në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- diplomë për përfundimin e arsimit të lartë nga fusha e mbrojtjes gjatë punës, drejtimi teknik ose drejtim tjetër që përputhet me veprimtarinë e punëdhënësit (diplomë për përfundimin e arsimit të lartë katërvjeçar ose diplomë me 300 kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS); dhe
- vërtetim për të paktën pesë vite përvojë pune pas diplomimit, në fushën përkatëse për të cilën është paraqitur kërkesa për dhënie e provimit profesional.

PARALAJMËRIM: Vërtetimi për shtetësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe vërtetimi se me vendim të formës së prerë nuk i është shqiptuar ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës, përderisa zgjasin pasojat e ndalimit, sigurohen me detyrë zyrtare.

Shkup, _____

Parashtruesi i kërkesës